

# Relacion mbi zhvillimin e takimit me organizatat e shoqërisë civile për personat me aftësi ndryshe në kuadër të procesit të bashkë-krijimit të Planit të Veprimit për Partneritetin për Qeverisje të Hapur (OGP) 2026–2030

## Takimi

Në datën 07/04/2026 u zhvillua një takim ndërmjet stafit të Agjencisë Kombëtare të Shoqërisë së Informacionit (AKSHI) dhe organizatave të shoqërisë civile që përfaqësojnë personat me aftësi ndryshe. Takimi u organizua në kuadër të procesit të bashkë-krijimit të Planit të Veprimit OGP 2026–2030, me synim përfshirjen aktive të këtyre organizatave në identifikimin e prioriteteve dhe nevojave konkrete në fushën e aksesueshmërisë digjitale.

## Qëllimi i takimit

Qëllimi i takimit ishte prezantimi i Partneritetit për Qeverisje të Hapur (OGP) dhe i procesit të hartimit të Planit të Veprimit 2026–2030, si dhe mbledhja e komenteve dhe sugjerimeve nga organizatat e shoqërisë civile për përmirësimin e aksesueshmërisë së faqeve web dhe shërbimeve publike digjitale. Në këtë kuadër, u prezantuan në mënyrë të përmbledhur edhe angazhimet e realizuara gjatë Planit të Veprimit 2023–2025, si dhe u theksua rëndësia e bashkëpunimit me këto organizata për hartimin e një plani gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave të qytetarëve.

## Çështjet kryesore të diskutuara

Gjatë takimit, organizatat pjesëmarrëse dhanë komente dhe sugjerime konkrete, të cilat fokusohen kryesisht në përmirësimin e aksesueshmërisë dhe përdorshmërisë së shërbimeve digjitale:

- Nevoja që faqet web institucionale të jenë të lexueshme nga programet “screen reader” dhe të përputhen me standardet ndërkombëtare të aksesueshmërisë (WCAG), duke garantuar strukturim të qartë dhe navigim të lehtë.
- Përshtatja e përmbajtjes për teknologjitë ndihmëse si “screen readers” dhe “speech-to-text software”, për të siguruar akses të barabartë në informacion.
- Rritja e kontrastit të ngjyrave dhe organizimi më i mirë i tekstit, si dhe shmangia e përmbajtjes së gjatë dhe të komplikuar, për ta bërë informacionin më të lehtë për t’u perceptuar nga personat me aftësi të kufizuara.
- Rishikimi i mekanizmave të verifikimit si “captcha”, të cilët paraqesin barriera për përdoruesit me aftësi të kufizuara, si dhe identifikimi i alternativave më të aksesueshme.

- Thjeshtimi i njoftimeve për cookies, në mënyrë që të mos pengojnë navigimin dhe përdorimin e faqeve web.
- Përdorimi i një gjuhe sa më të thjeshtë dhe të kuptueshme, duke marrë në konsideratë edhe nevojat e moshës së tretë, e cila has vështirësi në përdorimin e teknologjisë.
- Propozimi për bashkëpunim me universitetet, me qëllim përfshirjen e studentëve me aftësi të kufizuara në testimin dhe përmirësimin e aksesueshmërisë së shërbimeve digjitale.

Në përfundim të takimit, u dakordësua që organizatave pjesëmarrëse t'u shpërndahet një link i një pyetëtori, nëpërmjet të cilit ato do të kenë mundësi të japin në mënyrë më të detajuar komentet dhe kërkesat e tyre lidhur me aksesueshmërinë e faqeve web dhe shërbimeve publike digjitale. Ky hap synon të sigurojë një mbledhje më të strukturuar të inputeve dhe të kontribuojë në hartimin e një Plani Veprimi gjithëpërfshirës dhe të orientuar drejt nevojave të të gjitha grupeve të shoqërisë.